ADHURIMET

NË DHJETË NETËT E FUNDIT TË RAMAZANIT

ملة ابرهيم

MILETI IBRAHIM

ADHURIMET

NË DHJETË NETËT
E FUNDIT TË RAMAZANIT

Titulli :

Adhurimet në dhjetë
netët e fundit të Ramazanit

Përmbledhi dhe Përshtati :
Ibn Naim

Botues : ملة ابرهيم
MILETI IBRAHIM

Publikimi : Ramadan, 1447

Kjo fletushkë përmban thenje nga bobloteka (El Himmah)

Falënderimi i takon Allahut, dhe paqja e bekimet qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, mbi familjen e tij, shokët e tij dhe mbi të gjithë ata që e pasojnë. Me ndihmën e Allahut, po paraqesim këtë material të shkurtër duke shpresuar që të jetë dobi për muslimanët dhe një përkujtim i sinqertë. më pas:

Buhariu ka transmetuar në kapitullin (Vepra në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit), dhe Muslimi në kapitullin (Përkushtimi i shtuar në dhjetë ditët e fundit të muajit Ramazan), nga Nëna e Besimtarëve, Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të), se ajo ka thënë:

“I Dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), kur hynin dhjetë ditët e fundit (të Ramazanit), e

shtrëngonte rrobën e tij (dmth. përkushtohej fort), e gjallëronte natën dhe i zgjonte familjarët e tij."

Ndërsa në një transmetim tjetër të Muslimit, nga ajo (Allahu qoftë i kënaqur me të), ka thënë:

"I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) përpiqej dhe përkushtohej në dhjetë ditët e fundit më shumë sesa përpiqej në kohë të tjera."

Pra, Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i veçonte netët e dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit me vepra të posaçme, tregonte kujdes të madh për adhurime dhe i nxiste të tjerët për to

Nga këto adhurime janë:

1. Gjallërimi i natës:

Kuptimi i gjallërimit të natës është ta kalosh atë duke qëndruar zgjuar në namaz, lexim Kur'ani, përmendje (dhikr) dhe adhurime të tjera. Nga hadithi mund të kuptohet se me këtë synohet gjallërimi i gjithë natës, ashtu siç mund të kuptohet edhe se synohet gjallërimi i pjesës më të madhe të saj. Prandaj, le të përpiqen ata që ngrihen natën dhe le të garojnë në këtë sipas mundësive që kanë.

2. Zgjimi i familjes:

Fjala e saj (Allahu qoftë i kënaqur me të): “dhe i zgjonte familjarët e tij” do të thotë se i zgjonte bashkëshortet e tij për t’u ngritur në adhurim. Nga Aliu (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i zgjonte familjarët e tij në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit [hadith hasen, e transmeton Tirmidhiu].

Nga Ibn Umeri transmetohet se Ibn el-Hattabi (Allahu qoftë i kënaqur me ta) kur kalonte gjysma e natës, i zgjonte familjarët e tij për namaz, duke lexuar ajetin:

“Dhe urdhëroje familjen tënde për namaz dhe bëhu i qëndrueshëm në të.”

(Ta-Ha: 132) *[Hadith i saktë, e transmeton Maliku në el-Muvatta].*

Dhe Sufjan eth-Theuri ka thënë:

“Më e dashur për mua është që, kur të hyjnë dhjetë ditët e fundit, njeriu të falë namaz nate (tehexhud)

3. Shtrëngimi i rrobës

Në shpjegimin e kësaj shprehjeje është thënë: se nënkupton përpjekje të madhe në adhurim.

Mirëpo ky shpjegim është i dobët, sepse Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) ka thënë: “u përpoq fort dhe e shtrëngoi rrobën”, duke e lidhur shtrëngimin e rrobës veçmas nga përpjekja e tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Shpjegimi i saktë, mbi të cilin janë dijetarët e mëdhenj, është se me “shtrëngimin e rrobës” nënkuptohet largimi nga gratë (marrëdhëniet bashkëshortore). Kjo përforcohet edhe nga fakti se ai (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) bënte itikaf në dhjetë ditët e fundit, dhe ai që është në itikaf është i ndaluar t’u afrohet grave.

4. Itikafi:

Itikafi është qëndrimi në xhami dhe përkushtimi i plotë ndaj adhurimit, si dhe shkëputja nga lidhjet dhe angazhimet e kësaj bote që na shpërqendrojnë nga ahireti. Në dy Sahihët Nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të) transmetohet se:

"Profeti (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) bënte itikaf në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit deri sa Allahu e mori shpirtin e tij, e pas tij bënë itikaf edhe bashkëshortet e tij."

Ai bënte itikaf pikërisht në këto dhjetë ditë që ta angazhonte tërë kohën e tij me adhurimin e Zotit të tij,

me përulje e bisedë me Të, me përmendjen e Tij dhe me lutje.

5. Kërkimi i Natës së Kadrit:

Për shkak të fjalës së tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të):

"Kërkojeni Natën e Kadrit
në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit."

(Muttefekun alejhi)

Dhe për shkak të fjalës së tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të):

“Kush e fal namazin e Natës së Kadrit me besim dhe duke shpresuar shpërblimin, i falen gjynahet e mëparshme.”

Vlera e kësaj nate tek Allahu i Lartësuar është shumë e madhe, dhe shpërblimi i adhurimit në të është i barabartë me shpërblimin e një mijë muajve në netë të tjera!

6. Leximi i Kur’anit:

Leximi i Librit të Allahut në këtë muaj ka një rëndësi të veçantë dhe të madhe. Allahu i Lartësuar ka thënë:

“Muaji i Ramazanit është ai në të
cilin është shpallur Kur’ani.”

(El-Bekare: 185)

I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishte shumë i kujdesshëm dhe i përkushtuar në studimin e Kur’anit me Xhibrilin (paqja qoftë mbi të) çdo natë të Ramazanit *[Muttefekun alejhi]*.

Leximi i Kur’anit bëhet edhe më i theksuar në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit në veçanti, sepse selefët kanë qenë shumë të përkushtuar në leximin e Kur’anit në këtë muaj,

për shkak të vlerës së madhe që e dinin se ka leximi në të, dhe këtë përkushtim e shtonin edhe më shumë në dhjetë netët e fundit *[Latā'if el-Me'ārif, Ibn Rexheb].*

Përfundim:

Janë vetëm edhe pak ditë dhe mbi ne do të hyjnë dhjetë ditët e fundit. Prandaj, o musliman, përvjel mëngët e seriozitetit dhe përpjekjes, sepse, pasha Allahun, ato janë një dhunti e madhe për atë që adhuron siç duhet, dhe janë një mundësi e madhe – ka dështuar dhe ka humbur ai që e ka shpërdoruar. Ato janë netët më të mira të vitit pa asnjë dyshim, ashtu siç e kanë sqaruar dijetarët.

O Allah, na bëj të arrijmë dhjetë netët e Ramazanit, na e lehtëso adhurimin e mirë në to, dhe dërgo paqe e bekime mbi Profetin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe shokët e tij.